

FIRMOS PËR TË HYRË!



AUTOR
KOLINDO VJERDHA

Ligji që na la pa mjekë


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2023

PËR

IN E VEÇANTË TË STUDENTËVE QË NDJ
MIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIL
JEKËSI E PËRGJITHSHME” NË INSTITU
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË

eneve 78 dhe 83, të Kushtetutës, me propozimin
di i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Neni 1
b

regullat veçanta për trajtimin e studentëve
uar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgj
ke të arsimit të lartë, sipas parashikimeve të legji
artë.

Neni 2
ë

urimin e firmave njëzore për kryerjen e shë
në institucionet shëndetësore në Republikën e
imit të regjistrave për trajtimin e veçantë të stu
integroar të studimit të ciklit të dytë
itu të arsimit të lartë.

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2023

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES:

1. Hyrje
2. Panorama e gjendjes së sistemit shëndetësor
3. Vendimi
4. Kategorizimi i detyrimeve sipas viteve të studimit
5. Boshllëqet e ligjit, potencial për akte korruptive
6. Kostoja për t'u çliruar nga barra detyruese
 - 6.1. Metodologjia për përlogaritjen e koston së plotë të programit të studimit “Mjekësi e Përgjithshme”
 - 6.2. Analiza financiare e koston për tarifën e studimit para VKM-së
 - 6.3. Analiza financiare e koston për një student mjekësie sipas VKM-së
7. Dualizmi mes shifrave të të njëjtit burim
8. Një “betejë” mes universiteteve publike dhe jopublike
9. Mungesa e transparencës në proces
10. Përfundime dhe rekomandime
11. Bibliografia



HYRJE

Ajo që u cilësua enigmatike në tetorin e vitit 2022 duket se mori kuptim në 9- mujin pasardhës kur kaloi në Kuvend “me procedurë të përshpëjtuar”. Kjo ishte koha e nevojshme që qeveria shqiptare të testonte opinionin publik dhe të gjente formën e përshtatshme për të kaluar një ligj që do detyronte mjekët e rinj të punonin në Shqipëri.

Ky raport analizon efektet që shkakton ligji për trajtimin e veçantë të studentëve të programit të integruar “mjekësi e përgjithshme” duke u ndalur në aspektin e kostove të reja financiare, por edhe në situatën aktuale të sistemit shëndetësor në vend sa i takon nevojave për mjekë të rinj. Në këtë kuadër synohet të jepet një informacion më i detajuar lidhur me detyrimet e reja kontraktuale që lindin me nënshkrimin apo jo të marrëveshjes së propozuar në momentin e regjistrimit në këtë program.

Ndër të tjera në raport trajtohet dhe riformatimi i tregut që ka po këtë ofertë akademike i parë nën suazat e kostove të reja që do përlllogariten. Nëpërmjet kësaj analizë do të kuptojmë më shumë se kush favorizon kë dhe kush është i favorizuar i madh në tregun kompleks të konkurrencës publik-privat.

Së bashku me analizën e elementëve ligjorë që përmban kjo vendimmarrje i kushtohet po ashtu një vëmendje e caktuar edhe atyre boshllëqeve ligjore të cilat mund të kthehen në potencial për abuzivitet, duke synuar parandalimin e tyre.

Duhet nënvizuar po ashtu që përgjatë analizës do të kuptojmë edhe efektet reale që një politikë e tillë do të sjellë mbi buxhetin e shtetit dhe si do të mirëmenaxhohet kjo situatë me kostot e reja që mund të shkaktohen. Këto janë kostot e drejtpërdrejta që nxisin edhe interesin e taksapaguesve shqiptarë, pasi kuptojnë format e alokimit të drejtpërdrejta të fondeve të mbledhura.

PANORAMA E GJENDJES SË SISTEMIT SHËNDETËSOR

Sistemi shëndetësor si çdo sektor tjetër në vend luhetet mes problematikave që kanë detyruar shpesh mjekët profesionistë të largohen nga vendi në kërkim të profesionalizmit, kushteve më të mira në punë dhe të ardhurave më të mira. Këto largime herë të etiketuara në diskurin publik si “eksod i trurit”, herë si “dështim i sistemit” e herë “si ngjarje të zakonshme” duket se kanë detyruar qeverinë të ndërmarrë masa shtrënguese deri në detyruese.

Në shifrat e publikuara nga OECD¹ përballësh me një kontradiktë mes asaj që duhet të definohet si “eksod” apo si “largime të kontrolluara”. Deri në vitin 2017 cilësohet në relacion se sipas të dhënave të OECD-së, rreth 770 mijë shqiptarë punonin në vende të tjera brenda OECD-së. Kjo vlerësohet si shifra e dytë më e ulët në rajon pas Malit të Zi, duke nënvizuar se rekordin më të lartë e mban Serbia me 2 486 mijë, pasuar nga Maqedonia e Veriut me 1 726 dhe Bosnia dhe Hercegovina me 1 129 mijë. Referuar këtyre shifrave janë larguar 430 mijë në pesë vite.

Në relacion cilësohet se sipas të dhënave të OECD-së deri në vitin 2022 janë afro 1200 mijë të trajnuar në Shqipëri që punojnë në vendet e OECD-së, kryesisht në Gjermani (53.3%), Itali (23.7%), SHBA (14.3%), Britaninë e Madhe (9%), Francë (3.3%), Kanada (2.7%), Greqi dhe Zvicër (2%). Kjo përbën një shkallë emigrimi prej 19.8%, pra e thënë ndryshe ndër 100 mijë 20 largohen. Pra sipas shifrave 80.2% e mjekëve zgjedhin të qëndrojnë në Shqipëri. Nëse analiza do përqëndrohej vetëm në këto shifra do të arrijmë në përfundimin se kemi të bëjmë me një situatë largimesh të kontrollueshme, por realiteti nuk është i tillë.

193 mijë për 100 000 banorë ofrojnë sot shërbimet në sistemin shëndetësor në vend, kur mesatarja e rajonit të Ballkanit Perëndimor është 260 mijë për 100 000 banorë, ndërsa e vendeve të BE 360 mijë për 100 000 banorë. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka vënë në dukje se Shqipëria ka një nga normat më të ulëta të mjekëve për banorë në nivel global. Këto shifra dëshmojnë për një krizë reale në sistemin shëndetësor, krizë kjo e paralajmëruar në vite dhe e shpërfillur në vazhdimësi nga qeveria duke e cilësuar si migrim i zakonshëm. Është dashur të ndërmerren në vazhdimësi politika mbështetëse për të parandaluar eskalimin në një situatë të tillë ku qeveria tashmë detyrohet të përdorë forcën e ligjit për të normalizuar krizën.

Dy janë faktorët më të elaboruar që po detyrojnë mjekët të largohen nga vendi: pagat më të larta dhe kushtet më të mira në punë. Të ndalemi së pari te pagat. Me vendimin e fundit të ndërmarrë për rritjen e pagave në prill të këtij viti rezulton se rritja reale, pra e indeksuar nga inflacioni, është 0.3% për kategorinë mjekë të përgjithshëm. Referuar shifrave kemi të bëjmë me një rritje të papërfillshme sa i takon ndikimeve që ajo ka në rritjen e konsumit dhe të mirëqënies.

Mungesa e kushtet në punë është cilësuar gjithmonë si një element që nxit profesionistët në kërkim të mundësive të reja të punësimit. Për të dëshmuar këtë mund të citojmë gjetjet e raportit² të Kontrollit të Lartë të Shtetit lidhur me kushtet dhe ofertën e shërbimeve në Spitalin Onkologjik, pjesë e Spitalit Universitar “Nënë Tereza”. Citohet nga raporti i KLSH-së

¹ The Organization for Economic Cooperation and Development

² [Raporti Përfundimtar i Auditimit të Performancës "Trajtimi i sëmundjeve tumorale"](#)

“Drejtoria e Përgjithshme e Qendrës Spitalore Universitare Tiranë “Nënë Tereza”, nuk ka mundur të sigurojë pajisjen mjekësore të Brankiterapisë, të disa elementëve (Tubusa, Pompa dhe Maska termo plastike), nuk ka mundur në kohë të realizojë rehabilitimin e ambienteve për përshtatjen e vendosjes së pajisjes së Ortovoltazhit”, po ashtu citohet “...mungesa e infrastrukturës së nevojshme të godinës së spitalit, ndikon negativisht në cilësinë e shërbimit të pacientëve duke ulur besimin për një shërbim spitalor të denjë dhe të pastër duke treguar se shërbimi i Spitalit Onkologjik, nuk ka efektivitet të plotë, për trajtimin e sëmundjeve tumorale për periudhën në auditim”.

Gjatë gjetjeve janë konstatuar se në spitalin Onkologjik numri i poltronëve “shtrat virtual” është në sasi të vogël vetëm 19 poltrona, ndonëse gjatë ditës trajtohen me kimioterapi 75-80 pacientë, po ashtu është nënvizuar se në spital mungon sistemi i kondicionimit, dhomat e pacientëve të katit të III kanë prani të lagështirës si dhe kati nëntokë i godinës së është jo funksional i cili aktualisht shërben si vend grumbullimi për pajisjet e amortizuara. Niveli i papastërtisë në katin nëntokë është mjaft i lartë dhe përbën risk potencial për infektim. Në Spitalin e Traumës po ashtu konstatohet se nuk ka frigoriferë morg që përdoren për mbajtjen e trupave të pacientëve që humbin jetën. Gjithashtu në raport citohet “mungesa e disa medikamenteve sipas protokollit mjekësor për spitalet rajonale”. Ky është vetëm një rast i audituar që tregon kushtet në një nga spitalet me fluksin më të madh të pacientëve, kushte në të cilat duhet të punojnë mjekët e specializuar.

Në një situatë të tillë rekomandohet të ketë rritje të buxhetit për shëndetësinë i cili t’i dedikohet në mënyrë specifike infrastrukturës në spitalet e vendit për të rritur kështu edhe rendimentin e punës së mjekëve. Po ashtu duhet planifikuar në një periudhë afatmesme buxhetore një rritje reale e pagave për kategorinë “mjekë të përgjithshëm” dhe “infermierë” si element motivues në punë.

VENDIMI

Dekretohet dhe paraqitet në Fletoren Zyrtare Nr.123, datë 16.08.2023 LIGJI Nr.60/2023 “PËR TRAJTIMIN E VEÇANTË TË STUDENTËVE QË NDJEKIN PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MJEKËSI E PËRGJITHSHME” NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË”, i cili sanksionon nënshkrimin e marrëveshjes para regjistrimit si fitues në këtë program, e cila lidhet ndërmjet studentit, ministrisë përgjegjëse për arsimin, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit të arsimit të lartë publik për të punuar në profesionin e mjekut pas përfundimit të studimeve për jo më pak se 5 (pesë) vjet në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Me këtë ligj, qeveria shqiptare kushtëzon diplomën e studentëve të programit të integruar “Mjekësi e Përgjithshme” deri në momentin e shlyerjes së detyrimit, ose në të kundërt do të detyrohen të paguajnë vlerën e plotë të kostos së studimit. Metodologjia për përcaktimin e kostos së studimit do të njehsohet me Vendim të Këshillit të Ministrave.


Paradoksi qëndron në objeksionin e përcaktuar të këtij ligji, i cili definohet si një masë nxitëse për mjekët që të qëndrojnë në Shqipëri, kur në fakt mirëfilltazi ky është një ligj obligativ për ta, pra detyron shlyerjen e kontributeve me punë të detyruar në sistemin shëndetësor.

Në ligj përkufizohet një term specifik “trajtim i veçantë”, pra që thekson faktin e një punësimi dhe strehimi prioritar për studentët që kategorizohen të tillë. Me këtë përkufizim në ligj qartazi studentët e mjekësisë po veçohen nga statusi i përgjithshëm i një studenti. Ligji prezumon punësim të detyruar gjë e cila normalisht do të ndiqet edhe me politika prioritare të strehimit social për mjekët e rinj që do të punësohen, pra kemi të bëjmë me një rrjedhim të kushtëzuar. Masa e subvencionimit të interesave të kredisë për strehim llogaritet si diferencë midis interesit të dakordësuar me institucionet financiare dhe interesit që paguan studentit sipas legjislacionit në fuqi për strehimin social. Kjo mund të përkthehet në kosto shtesë në buxhetin e shtetit për akomodimin e mjekëve të rinj dhe një riklasifikim i kategorive përfituese me prioritet.

KATEGORIZIMI I DETYRIMEVE SIPAS VITEVE TË STUDIMIT

Në nenin 4 të ligjit bëhet një ndarje në kategori përfituese duke shtresëzuar kështu sipas fashave të caktuara detyrimet. Nëse studentët që nisin në këtë vit siparin e rrugëtimit të tyre akademik gëzojnë sot një informacion paraprak, pra para se ato të zgjedhin degët preferenciale, e kundërta mund të thuhet për ato që aktualisht studiojnë në degën e Mjekësisë së Përgjithshme në vitet respektive. Për këto studentë kishte një ndryshim të theksuar kursi, duke shfuqizuar në mënyrë eksplicite kontratën me të drejta dhe detyrime që studentit ka nënshkruar në momentin e regjistrimit në degën e përzgjedhur. Kjo mund të cilësohet si një ndryshim i rregullave në mes të procesit, i padrejtë në dukje dhe në thelb, por tashmë një ligj i botuar në Fletore Zyrtare.

Për kategorinë e studentëve të vitit të dytë deri në të katërt do duhet të nënshkruajnë një kontratë të re me institucionin e arsimit të lartë, ministrinë përkatëse të arsimit dhe ministrinë përkatëse të shëndetësisë për kushtëzimin e diplomës së tyre deri në shlyerjen e detyrimit të kontributit në punë të detyruar, minimalisht 3 (tre) vite, në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.



Ndërsa për kategorinë studentë të vitit të pestë dhe të gjashtë do duhet të nënshkruajnë po ashtu një kontratë të re me institucionin e arsimit të lartë, ministrinë përkatëse të arsimit dhe ministrinë përkatëse të shëndetësisë për kushtëzimin e diplomës së tyre deri në shlyerjen e detyrimit të kontributit në punë të detyruar, minimalisht 2 (dy) vite, në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Një vendim i tillë kushtëzon kryerjen e një specializimi në institucionet e arsimit të lartë në vend, pasi pas pesë, tre apo dy vitesh është e vështirë për një student të ndërmarrë një rrugëtim të ri akademik për t'u profilizuar në një universitet jashtë vendit, shtuar këtu edhe profilet e kufizuara të specializimit që ofrojnë institucionet arsimore në vend. Ky argument bazohet në Nenin 6 të ligjit i cili kushtëzon se shlyerja e detyrimit nis "nga momenti i lindjes të së drejtës për punësim", pra menjëherë pas kryerjes së programit të integruar për Mjekësi të Përgjithshme. Duket se të tilla teknikalitete të cilat janë ende të pazbardhura janë thelbësore për karrierën e mjekëve të rinj, të cilët me këtë vendim nuk po trajtohen në dinjitetin e profesionit që kanë zgjedhur, por si një numër që duhet plotësuar për të mbuluar difiçitet e një sistemi që nuk ka arritur të bind këto mjekë të qëndrojnë.

BOSHLLËQET E LIGJIT, POTENCIAL PËR AKTE KORRUPTIVE

Nëse në shumë ligje forca e argumentit dhe çasja ndaj këndvështrimit më të drejtë mund të jenë luhatjet normale në perifrazimin e efekteve të tij, në rastin konkret ka disa elementë praktik që mund të kthehen shumë lehtë në elementë abuzues me to. Në këtë pjesë po analizojmë efektet që ky ligj tashmë i miratuar mund të sjellë dhe elementët që nuk duhen anashkaluar në hartimin e udhëzimeve.

Së pari, ligji e lë të hapur mundësinë e shlyerjes së detyrimit si në institucione publike dhe në ato private të kujdesit shëndetësor e kushtëzuar vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por nuk e përcakton qartë se si do të bëhet një ndarje e studentëve që do të zgjidhen në një të njëtrën apo tjetër kategori. Diferencat mes sektorit publik dhe atij privat janë të njohura tashmë si në kushtet e punës, por edhe në nivelin e ndryshëm të pagave për kategori të njëjta.

Ka mungesa udhëzimesh që përcaktojnë se mbi çfarë kriteresh do të bëhet përzgjedhja mjekëve të rinj në pozicionet vakante mes sistemit të shërbimit shëndetësor privat dhe publik, sa alternativa ka të drejtë të refuzojë një i sapodiplomuar pasi mund të mos i përshtaten me kushtet që ndodhet, si do të integrohet procesi me mjekët jo të sapodiplomuar që duan të konkurojnë për pozicione vakante. Pra janë një sërë pyetjesh pa përgjigje të cilat kanë mbetur të pazbardhura dhe që krijojnë

mundësi potenciale për t'i anashkaluar ato në këtë fazë të procesit që ndodhemi.

Së dyti në Nenin 6 të ligjit theksohet:

“Në rast mospunësimi të tij brenda 1 (një) viti kalendarik nga data e lindjes të së drejtës për punësim sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohet i përmbushur detyrimi sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe ka të drejtën të pajiset me diplomën përkatëse universitare.”

Kjo është pikë që ligji e përdor për të shfryrë përgjegjësitë, por që nga ana tjetër krijon polemika se si mundet një student të anashkalojë detyrimin kur predispozohet se ligji vepron njëloj mbi të gjithë. Pra sipas kësaj pike mjafton të anashkalosh në procedurë 1 vit kalendarik si i papunësuar (pa mundësi punësimi në sistemin shëndetësor publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë) dhe mund të njehsohesh nga shteti si i lehtësuar nga barra e detyrimeve ndaj tij. Ky boshllëk ligjor i krijuar mund të jetë një element potencial për të abuzuar duke trajtuar në mënyrë disproporcionale nesër studentët e sapodiplomuar. Një hendek i tillë i normuar në akt ligjor do të kthehet si një alternativë korruptive për të shpëtuar nga barra detyruese. Në këto kushte qeveria dhe ministritë e linjës duhet të qartësojnë në çdo element procedurën e përzgjedhjes dhe të ofrojnë transparencë në proces.

KOSTOJA PËR T'U ÇLIRUAR NGA BARRA DETYRUESE

Në Nenin 5 të ligjit sanksionohet:

“Studenti që nuk pranon të nënshkruajë marrëveshje për të punuar në një institucion shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, publik ose privat, nga data e lindjes të së drejtës për punësim me ministrinë përgjegjëse për arsimin, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionin e arsimit të lartë publik sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 4 të këtij ligji, paguan vlerën e plotë të kostos së studimeve. Metodologjia për përcaktimin e kostos së studimeve për programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë dhe çdo mbështetje tjetër për studentët e këtij programi studimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Pra studentët që aktualisht janë duke ndjekur studimet në këtë degë ndodhen mes dy zgjedhesh, ose të paguajnë vlerën e kostos së plotë të studimeve për vitet e ngelura, ose të pranojnë “trajtimin e veçantë”. Nga njëra ana çënohet karriera dhe e ardhmja, ndërsa nga ana tjetër çënohet buxheti familjar që duhet të paguajë për t'u çliruar nga barra detyruese. Duhet theksuar që në asnjë pikë të ligjit nuk cilësohet që studentët që zgjedhin të nënshkruajnë marrëveshjen përjashtohen nga

pagesa e tarifës së studimit e cila deri më tani përbën afro 18% të kostos së plotë të studimit në këtë degë referuar kostos së re të përlogaritur. Pra studentët do të vazhdojnë të paguajnë tarifën e përcaktuar mesatarisht 45 000 lekë në vit edhe nëse do të zgjedhin të nënshkruajnë marrëveshjen.

Metodologjia për përlogaritjen e kostos së plotë të programit të studimit “Mjekësi e Përgjithshme”

Institucionet përgjegjëse do të përcaktojnë koston reale të studimit, e cila do të realizohet sipas një metodologjie të përcaktuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.527, datë 07.09.2023. Sipas këtij vendimi cilësohet se elementët kyç, mbi të cilat do të bazohet metodologjia e përlogaritjes së kostos, janë shpenzimet e personelit, të cilat në institucionet e arsimit të lartë publik vlerësohen rreth 75% deri në 80% të kostos së studimit, shpenzimet korrente për blerje mallrash dhe shërbimesh të cilat vlerësohen rreth 15% deri në 20% të shpenzimeve të personelit dhe shpenzimet kapitale të cilat zënë rreth 10% deri 15% të shpenzimeve të personelit.

“Tarifa e re” e përlogaritur që përbën vlerën e kostos së plotë të studimit në rast të mosnënshkrimit të marrëveshjes do t’i referohet vetëm viteve të ardhshme akademike, pra nuk do të ketë efekte prapavepruese. Studentët që janë aktualisht duke e ndjekur këtë program studimi do të paguajnë koston e plotë nëse nuk zgjedhin “trajtimin e veçantë” vetëm për vitet e ngelura të studimit sipas përlogaritjeve përkatëse.

Analiza financiare e kostos për një student mjekësie para VKM-së

Në bazë të kërkesës për informim që Qëndresa Qytetare drejtoi ndaj IAL³ Universitetit të Mjekësisë lidhur me formën e përcaktimit të kostos së studimit për një student në degën e Mjekësisë së Përgjithshme nuk morëm një përgjigje zyrtare. ndonëse ishte lajmëruar se kjo kosto do të përlogaritej para fillimit të vitit akademik. Në muajin Korrik në një tjetër kërkesë për informim IAL Universiteti i Mjekësisë na paraqet në përgjigjen e tij një kosto totale prej 647 143 Lekë për një student në vit, pra afërsisht 6,148€/vit⁴, kjo një kosto e llogaritur para se të miratohej VKM-ja për metodologjinë e re në përlogaritjen e kostos. Ky është edhe informacioni i fundit i marrë nga ky universitet, pasi nuk ka të përlogaritur akoma asnjë kosto të re.

³ Institucioni i Arsimit të Lartë

⁴ 1 Lek = 0,0095 EUR

Kostoja totale për një vit studimi e paraqitur më lart përlllogaritët të mbulojë shpenzimet për paga të punonjësve mësimorë, shpenzimet për paga të punonjësve ndihmës-mësimorë, shpenzimet në sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit, shpenzimet për shërbime dhe shpenzimet për investime. Deri më tani për një mesatare prej 6 studentësh për një punonjës mësimor janë përlllogaritur në total 216,145,697 Lekë shpenzime në një vit buxhetor.

Fig.1 Pasqyra e kostos totale për programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”

	Shpenzime për paga për punonjësif mësimorë	Shpenzime për paga të punonjësve ndihmës-mësimorë	Totali i shpenzimeve për paga	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	Shpenzime për shërbime	Shpenzime për investime	Kosto totale
	1	2	3	4	5	6	7
Formula e llogaritjes			(1+2)	16.7% x (3)	25% x (1)	25% x (1)	(3)+(4) + (5) + (6)
Kostot e përlllogaritura	108296160	30519250	138815410	23182173	27074040	27074040	216 145 697

Burimi: IAL “Universiteti i Mjekësisë”

Kostoja aktuale përlllogaritët mbi kuotat e deritanishme të pranimit që kanë qënë 334 studentë gjë e cila do të ndryshojë me vendimin e fundit duke u shtuar në 400 kuota pranimit. Në këto kushte të reja mund të ketë dhe një riklasifikim të kostove duke përlllogaritur kostot shtesë që mund të ketë në shërbime dhe investime.

Analiza financiare e kostos për një student mjekësie sipas VKM-së

Bazuar në metodologjinë e miratuar, në Vendimin Qarkullues Nr.109, datë 06.10.2023 u përcaktua nga Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë se kostoja për një student në një vit akademik do të jetë 248,975 lekë/vit apo 2400€/vit.

Fig.2 Kosto në vit për një student për programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”

	Të dhëna për programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme” (lekë)
--	---

KOSTO DIREKTE	
Fondi personeli	387,034,231
Shpenzime për bursa	76,400,000
Kosto totale direkte	463,434,231
KOSTO INDIREKTE	
Shpenzime Kapitale 10% mbi fondin e pagave	38,703,423
Shpenzime Operative 15% mbi fondin e pagave	58,055,135
Kosto totale indirekte	96,758,558
Kosto totale (direkte + indirekte)	560,192,789
Numri i kuotave të certifikuara të studentëve MP viti akademik 2023- 2024	2,250
KOSTO PËR STUDENT	248,975


Burimi: IAL “Universiteti i Mjekësisë”

Konstatohet se kosto e re e përlogaritur është 3 herë më e ulët se ajo e paraqitur në relacionin e dërguar për miratimin e ligjit në Parlamentin e Shqipërisë. Pra vendimmarrja e ligjvënësve kur kanë miratuar këtë ligj është bazuar edhe mbi kostot fiktive dhe të tejfryra që buxheti i shtetit paguan për një student të mjekësisë, kur në fakt kjo kosto e përlogaritur nga vetë Bordi i Administrimit është 3 herë më e ulët.

Kostoja e e përlogaritur i përafrohet koston së 3 viteve më parë të raportuar nga vetë universiteti që ishte rreth 2200€/vit. Këto dualitete të shifrave ngjallin pikëpyetje lidhur me vërtetësinë e shifrave të referuara në relacionin e projektligjit, duke ndikuar kështu në përceptime të gabuara se sa vërtetë i “kushton” buxhetit të shtetit shkollimi i një studenti të mjekësisë.

DUALIZMI MES SHIFRAVE TË TË NJËJTIT BURIM

Në ligj parashikohet që aktet nënligjore dhe udhëzimet të bëhen transparente brenda 6 mujorit të ardhshëm. Një theks i veçantë duhet t'i kushtohet përcaktimit në mënyrë të saktë dhe paekuivoke të vlerës reale të koston së studimit në degën “Mjekësi e Përgjithshme”.



Referuar të dhënave të marra nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë është përlogaritur kosto e studimit për këtë program në vitin 2019, nga se rezulton që kosto mesatare e përlogaritur është 236,468 Lekë/vit, ose e thënë ndryshe afërsisht 2,200 €/vit.

Si është e mundur që kostoja e studimit të jetë rritur me afro 4,000€ në vetëm 4 vite? Ky është një krahasim në kosto që përlogaritet pavarësisht vendimit të fundit të ndërmarrë nga qeveria. Pra një kosto që rritet mesatarisht me 1,000€ në vit për një student. Kjo ngre padyshim pikëpyetje se cilët janë indikatorët që kanë ndikuar në këtë rritje e cila nuk është në proporcion me rritjen në shërbime dhe investime.


Referuar Buxhetit të publikuar të vitit 2022 të Fakultetit të Mjekësisë rezulton se 16% të shpenzimeve totale e zënë "Materialet dhe Shërbimet e specializuara" pjesë e të cilave janë "Librat dhe Publikimet Profesionale", pra shërbimet bazë të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Paradoksale është se afro në të njëjtën përqindje të shpenzimeve totale zë vetëm zëri "Shpenzime për Sigurimin e Ndërtesave dhe të tjera kosto sigurimi të ngjashme", e thënë me thjeshtë shpenzimet për siguri godine barazojnë shpenzimet totale për materiale dhe shërbime të nevojshme për zhvillimin e mësimdhënies në universitet. Këto shifra reflektojnë prioritetet që vetë universiteti ka përcaktuar për zhvillimin e jetës akademike. Në këtë formë shpërndahen fondet që sigurohen nga grantet qeveritare dhe të ardhurat e siguruar nga tarifat e studimit të paguara drejtpërdrejt nga studentët.

Dëshira për ta kaluar sa më shpejt këtë ligj në parlament ka prodhuar një amulli shifrash sa i takon vlerës së kostos së studimit, ku të gjitha kanë të njëjtin burim reference IAL Universiteti i Mjekësisë, Tiranë. Në relacionin e dorëzuar kuvendit për miratimin e projektligjit të atëherëshëm, vlera e kostos në një vit përlogaritej 678,994 lekë për një student, pra afërsisht 6,450€. Në dy dokumente të ndryshëm referohet i njëjti institucion, por që detajon dy kosto që lëvizin mes tyre me një diferencë prej 302€.

Në këto kushte për të mos krujuar edhe insinuata të panevojshme ministritë e linjës duhet të saktësojnë qartë se sa i kushton sot shtetit shqiptar një student i mjekësisë. Dëshira për ta kaluar me procedurë të përshpëjtuar ka prodhuar shifra fiktive që nuk rakordojnë mes tyre, duke cënuar kështu seriozitetin e vendimmarrjes.

NJË "BETEJË" MES UNIVERSITETEVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE

Formulari i aplikimit i maturantëve, në listën e 10 preferencave, mund të rendisë si universitete publike ashtu edhe ato jopublike duke i bashkuar ato në një treg të një konkurrence të pastër. Kjo nuk duket e këfillë me



vendimin e fundit të qeverisë për të vendosur “trajtimin e veçantë” që prek vetëm studentët e universitetit publik.

Në Shqipëri sot janë tre IAL që kanë në ofertën e tyre akademike degën “Mjekësi e Përgjithshme”, dy prej të cilave universitete jopublike. Universiteti “Western Balkan University” do ta hap këtë degë për herë të parë në këtë vit akademik duke shtuar kështu mundësitë që studentët kanë për të zgjedhur praktikat mësimore që ofrojnë universitete të ndryshme.

Fig.2 IAL-të që ofrojnë degën “Mjekësi të Përgjithshme”

Institucioni i Arsimit të Lartë	Kosto totale(€)/vit
Universiteti “Western Balkan University”	7 500€ ⁵
Universiteti katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”	5 000€ ⁶
Universiteti i Mjekësisë Tiranë	2 400€ ⁷

Ky ligj favorizon universitetet jopublike të cilat janë të lehtësuara nga barra e punës së detyruar për studentët që zgjedhin të studiojnë në to. Ishte paradoksale që kosto vjetore për një student të mjekësisë (referuar koston së përcaktuar në relacionin e projektligjit) në një universitet publik të ishte më e lartë se ajo në universitetet jopublike, kur këto të fundit pjesë të tarifës kanë edhe fitimin e njësisë ekonomike, aq më shumë pastaj nëse i referohemi kushteve dhe ofertës akademike të tyre.

Deri më sot është synuar shumë në diskurin publik të diskutohen për diferencat mes IAL-ve publik dhe jopublik duke u përqëndruar sidomos në aspektin e ofertës akademike, kushteve infrastrukturore dhe laboratorëve, ndërsa tani spektrit të diferencave thelbësore i është shtuar edhe tarifa e studimit dhe mbi të gjitha çlirimi nga barra detyruese e cila duhet të shlyhet nëse zgjedh universitetin publik.

MUNGESA E TRASPARENCËS NË PROCES

Transparenca është vlera e shtuar e një procesi që i jep atij mbi të gjitha kredibilitet dhe besueshmëri në sytë e qytetarit. Lidhur me këtë ligj që po mban peng studentët e mjekësisë ngrihen shumë pikëpyetje duke nisur nga firmosja e kontratës e deri te kriteret dhe mekanizmat që do përdoren për të bërë shpërndarjen e mjekëve të rinj në pozicionet vakante të punës.

⁵ [Pasqyra e tarifave sipas programeve të studimit në WBU](#)

⁶ [Pasqyra e tarifave sipas programeve të studimit në ZKM](#)

⁷ Kosto e përlogaritur nga IAL Universiteti i Mjekësisë Tiranë, sipas VKM-së së miratuar

Është konstatuar që në pikënisje të vitit të ri akademik dhe para testimit të kryer nga studentët e vitit të parë nuk i është paraqitur asnjë kontratë për ta firmosur lidhur me marrëveshjen e sanksionuar në ligj që këta studentë duhet të kishin me Ministrinë e Arsimit dhe rektoratin lidhur me "Trajtimin e veçantë".


Referuar Nenit 4 të ligjit në pikën 1 të tij citohet:

"Trajtim të veçantë përfiton kandidati që pranohet në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë "Mjekësi e përgjithshme" në institucionet publike të arsimit të lartë kur plotëson deklaratën për përmbushjen e kushteve, parashikuar në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni përpara zhvillimit të testimit të detyruar për pranimin në këtë program studimi."

Në këto kushte studentëve i lind e drejta të mos e nënshkruajnë një marrëveshje të fillë, për aq kohë sa ajo nuk i është paraqitur brenda afateve që sanksionon ligji. Kjo vlen edhe për studentët që po ndjekin studimet në vite të tjera dhe që janë subjekt i ligjit.


Nga ana tjetër edhe pse me kërkesa zyrtare drejtuar institucioneve përkatëse, nuk jepet ende informacion prej tyre lidhur me numrin e pozicioneve vakante që ka nevojë sistemi shëndetësor në vend, nuk jepet informacion se si do të jenë projeksionet e kësaj nevoje në vitet në vijim.

Transparenca duhej të ishte kryefjala e këtij procesi dhe asnjë informacion nuk është i tepërt për të ndërtuar një analizë të plotë mbi atë ç'ka është situata në vend dhe ku synojmë të arrijmë. Institucionet duhet të jenë ato pararojë e informimit dhe jo ky informacion të merret në fund të çdo hallke ligjore që parashikon ligji.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Në relacion cilësohet se sipas të dhënave të OECD-së deri në vitin 2022 janë afro 1200 mjekë të trajnuar në Shqipëri që punojnë në vendet e OECD-së. Në pesë vite janë larguar 430 mjekë.
- Shkalla e emigrimit të mjekëve është afërsisht 19.8%, pra e thënë ndryshe ndër 100 mjekë 20 largohen nga vendi.
- 193 mjekë për 100 000 banorë ofrojnë sot shërbimet në sistemin shëndetësor në vend, kur mesatarja e rajonit të Ballkanit Perëndimor është 260 mjekë për 100 000 banorë, ndërsa e vendeve të BE 360 mjekë për 100 000 banorë.
- Dy janë faktorët më të elaboruar që po detyrojnë mjekët të largohen nga vendi: pagat më të larta dhe kushtet më të mira në punë.
- Ligji e lë të hapur mundësinë e shlyerjes së detyrimit si në institucione publike dhe në ato private të kujdesit shëndetësor e kushtëzuar vetëm brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, por nuk e përcakton qartë se si do të bëhet një ndarje e studentëve që do të zgjidhen në njërën apo tjetrën kategori.
- Bazuar në metodologjinë e miratuar, në Vendimin Qarkullues Nr.109, datë 16.10.2023 u përcaktua nga Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë se kostoja për një student në një vit akademik do të jetë 248,975 lekë/vit apo 2400€/vit.
- Ky ligj favorizon universitetet jopublike të cilat janë të lehtësuara nga barra e punës së detyruar për studentët që zgjedhin të studiojnë në to.
- Në Nenin 6 të ligjit nënvizohet se mjafton të anashkalosh në procedurë 1 vit kalendarik si i papunësuar dhe mund të njëhsohesh nga shteti si i lehtësuar nga barra e detyrimeve ndaj tij. Ky element mund të cilësohet si potencial për korrupsion dhe abuzim.
- Kontrata për "Trajtimin e veçantë" nuk i është paraqitur studentëve brenda afateve të parashikuara në ligj, gjë që këtyre të fundit i lind e drejta të mos e nënshkruajnë atë.
- Mungesa e transparencës ka qënë kryefjala e këtij procesi, ku nuk është gjetur një gjuhë bashkëpunimi me institucionet lidhur me marrjen e informacionit të nevojshëm.



BIBLIOGRAFIA

FLETORJA ZYRTARE (2023, Korrik 21) Ligj nr. 60/2023 ([Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë Nr.123, Datë 21/07/2023](#))

Relacioni për projektligjin “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme” në institucionet publike të arsimit të lartë” (Qershor 2023)

Tarifa vjetore IAL Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” ([Pasqyra e tarifave sipas programeve të studimit në ZKM](#))

Tarifa vjetore IAL “Western Balkans University” ([Pasqyra e tarifave sipas programeve të studimit në WBU](#))

“Migrimi i fuqisë punëtore në Ballkanin Perëndimor”, OECD ([Migracioni i fuqisë puntore në Ballkanin Perëndimor](#))

Raporti Përfundimtar i Auditimit të Performancës “Trajtimi i sëmundjeve tumorale”, Kontrolli i Lartë i Shtetit, 2023 ([Raporti Përfundimtar i Auditimit të Performancës “Trajtimi i sëmundjeve tumorale”](#))

Udhëzim Nr.20, (2023, Shtator 01) “Për përcaktimin e mënyrës dhe procedurës së punësimit me prioritet, të mjekëve që përfitojnë trajtim të veçantë, në institucionet shëndetësore, në Republikën e Shqipërisë.

Vendimi Qarkullues i Bordit të Administrimit të Universitetit të Mjekësisë Nr.109, (2023, Tetor 06) “Për miratimin e kostos së studimit të programit të integruar të studimit të ciklit të dytë “Mjekësi e Përgjithshme”, që ofrohet nga Fakulteti i Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”



#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al